



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:260963  
Datë: 17.12.2020  
Numri i dokumentit: 01350107

**A.nr.1011/19**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, dhe me sekretaren juridike Fexhrie Tashevci, në konfliktin administrativ të paditësit [“M...” sh.p.k] me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqeria e Avokatëve[“S...”]me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit nr. 01.3.2.2/2459 te dt. 21.03.2019, në seancën e shqyrtimit kryesor-publik, të mbajtur në prani të përfaqësueses së autorizuar të paditësit [G.B] me autorizim dhe në mungesë të paditurës, me datë 08.12.2020, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit [“M...” sh.p.k] me seli në Prishtinë, si e bazuar.
- II. ANULOHET Aktvendimet nr. 01.3.2.2/2459 te dt. 21.03.2019, i Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m**

Me vendimin kontestues, e paditura Dogana e Kosovës ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit nr.R-1994/30.01.2019 të lëshuar nga Zyra e Brendshme Doganore në Prishtinë.

Paditësi i pakënaqur me këtë vendim ka ushtruar ankesë në Gjykatë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës administrative, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe për rritje të pa arsyeshme të mallit, më tej, ka deklaruar se mbetet në tersi si në padi dhe kërkesëpadi. E paditura sipas aktvendimit kontestues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit kontestues me të cilin e ka kontestuar vlerën e deklaruar të mallit duke caktuar bazë të vetë doganore dhe duke obliguar të paditësin të paguaj ma tepër shumën e përgjithshme prej 12,833.30€, nga vendimi kontestues shihet se e paditura për vlerësimin e mallit është bazuar mbi të dhënat e disponueshme pa marr parasysh dokumentacionin përcjellës të mallit i cili vërteton vlerën realisht të paguar të mallit lëndor siç janë: fatura e blerjes së mallit dhe pagesat bankare të dt. 09.01.2019 dokumente këto të cilat tregojnë vlerën e paguar nga paditësi për mallin lëndor e paditura duke mos qenë në gjendje ti kontestoi këto dokumente ka cekur se ka munguar dokumente të cilat nuk kërkojnë ligjërish. Me sa u tha dhe duke pas parasysh pretendimet e cekura si dhe bazuar në provat e prezantuara kërkojmë nga kjo gjykatë të veproji sipas kësaj padie dhe të merr një vendim meritor. Andaj, kërkon nga gjykata aprovimin e padis si të bazuar dhe anulimin e vendimit kontestues si dhe të obligohet e paditura që paditësit të ja kthej detyrimeve doganore të paguara ma tepër në shumën e përgjithshme prej 12,833.30€

E paditura, përmes përfaqësueses së autorizuar në përgjigjen në padi deklaroi se konteston në tersi kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, andaj i propozon Gjykatës që pas administrimit të provave të marr Aktgjykim me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, dhe të mbetet në fuqi vendimi kontestues.

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ gjyqësor në pajtim dispozitat e nenit 41 të LKA-së, për arsye se përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës me parashtrësën datës 07.12.2020 e ka njoftuar Gjykatën se nuk mund të jetë prezent në seancë, andaj ka kërkuar që të vepohet në pajtim me nenin 38 paragrafi 5 të LKA-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik administruar provat dhe atë: Aktvendimi 01.3.2.2/2459 dt. 21.03. 2019, DUD-at R- 1994, Fatura dhe packing lista 1809-11907-2018 e dt 09.12 2018, Dokumenti i dt. 18.12.2018, Certifikatë e dt. 31.12.2018, Pagesat bankare dt. 09.01.2019, Unitrans container LTD dt. 23.12.2018, Procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallrave dt. 30.01.2019, Ankesa e parashtruar në doganë 27.02.2019.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81 G të Ligjit 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/L222, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, dhe konstatoi se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, andaj vendosi që lënda të kthehet në rishqyrtim për arsye se:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, gjykata nga DUD-it kontestues deklarimeve në ankesë, si dhe aktvendimi kontestues ka nxjerr konstatimin se paditësi ka deklaruar mallin lëndor sipas DUD-it kontestues me nr. R-1994/30.01.2019 të lëshuar nga Zyra e Brendshme Doganore Prishtinë duke ia bashkangjitur mallit lëndor dokumentacionin e nevojshëm, mirëpo zyra e pranimit qendror e ka vlerësuar mallin lëndor në bazë të metodës së gjashtë të vlerësimit, neni 35 të kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme, dhe në këtë rast paditësi është detyruar që të paguaj taksë doganore me të lartë se të deklaruar me faturat e mallrave.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadiës, në vështrim të nenit 44 të LKA-së Në arsyetimin e aktvendimit kontestues si arsye dhe fakt vendimtar që kanë ndikuar në mos pranimin e vlerës së transaksionit për mallin lëndor të zhdoganuar sipas DUD-it kontestues, e paditura ka theksuar se disponon të dhëna nga importe të mëhershme por me çmimi me të lartë në krahasim me mallin lëndor kontestues, andaj mbi këtë bazë është bërë edhe rivlerësimi i mallit lëndor.

Gjykata nga aktvendimi kontestues vëren se ai përmban të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, të metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestues përmban të dhëna të pamjaftueshme dhe jo të plote sa i përket rivlerësimit të mallit lëndor. Gjykata vlerëson se e paditura në arsyetimin e vendimit kontestues nuk e ka arsyetuar fare se përse paditësit nuk i është pranuar deklarimi i mallit sipas faturave dhe transaksioneve bankare, në bazë të metodës së parë të vlerësimit, kur paditësi ka prezantuar dokumentacionin valid që dëshmojnë për çmimin e paguar, e paditura nuk e ka mbështetur konstatimin e vet në asnjë dispozitë ligjore që do të përcaktonte se kontrata e shitblerjes dhe deklarata eksportuese duhet bashkangjitur faturës së mallit doganor, për tu aplikuar vlera e transaksionit të mallit konform nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave. Neni 33 i KDA-së parag. 1 parasheh shprehimisht se: *Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë.*

Gjykata konstaton se paditësi deklaratave doganore kontestuese i'a ka bashkangjitur faturat dhe transaksionet bankare me te cilat e ka paguar mallin lëndor, ndërsa vendimi kontestuese nuk përmban arsyetim konkret mirëpo vetëm një përmbledhje gjeneral dhe pa mbështetje ligjore, aplikimi i metodës së vlerësimit gjashtë respektivisht nenit 35 KDA-se, vjen ne shprehje vetëm atëherë kur paditësi nuk ka bashkangjitur dokumentacione përcjellës me te cilin e vërteton vlerën reale te çmimit te mallit, e jo si ne rastin konkret, me te cilin dëshmohet ne bazë te faturave dhe transaksioneve bankare. Gjykata ka shqyrtuar edhe bazën ligjore sa i përket dokumenteve qe parashihen ti bashkëngjiten deklaratës Doganore (DUD-it) gjate zhdoganimit te mallit, dhe vlerëson se ne baze te nenit 123 parag (a) te UA 11/2009 për zbatimin e Kodit Doganor dhe Akcizave shprehimisht parashihen, dokumentet qe duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë te mallit, *“fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”* nga kjo rezulton se paditësi ka paraqitur faturat dhe transaksionet bankar qe dëshmojnë çmimi e blerjes se mallit.

Dogana nuk ka arritur të dëshmojë pavlefshmërinë e faturës, transaksionit bankar si dhe dokumentacionit tjetër përcjellës. Gjithashtu nuk ka arritur të dëshmojë qartë se ku konsistojnë ato prova bindëse të cilat e bëjnë këtë dokumentacion të pakompletuar, jo origjinal dhe të pa harmonizuar më vlerën e mallit të paguar ose të pagueshme për mallin lëndor kontestues si dhe cilat veprime i ka marr Dogana e Kosovës e që janë në përputhje me dispozitat nga neni 92 par.1 dhe 2 të UA 11/2009 me të cilin parashihet se: *“Dogana mund të mos bëjë vlerësimin doganor të mallrave të importuara mbi bazën e metodës së vlerës së transaksionit në përputhje me procedurën e paraqitur në paragrafin 2 të këtij neni, dyshim i bazuar që vlera e deklaruar doganore paraqet shumën e përgjithshme të paguar apo të pagueshme në mënyrën e përmendur, sikur në Seksionin 33 të Kodit”* dhe *“Kur Dogana ka dyshime të bazuara dhe të përshkruara në Paragrafin 1 të këtij neni, ata mund të kërkojnë të dhëna shtesë në përputhje me nenin 88 (4) të këtij akti. Nëse dyshimet vazhdojnë, Dogana duhet para marrjes se vendimin final, të njoftojë personin përkatës, në formë të shkruar nëse kërkohet, për bazën e dyshimeve dhe t’i ofrojë atij mundësinë në afat kohor të arsyeshëm për përgjigje. Vendimi final me arsyetim i jepet personit me shkrim”*.

Vendimi i kontestuar nuk përmban një vlerësim të fakteve në raport me dispozitat ligjore për rivlerësim te mallit lëndor, andaj një vendim i tille nuk mund të quhet se është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se është marr me respektimin e dispozitave ligjore të Ligjit për Procedurën Administrative. Bazuar në nenin 81.F par.2 të ligjit Nr.04/L-102 të Udhëzimit Administrativ për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222 se: *“Administrata tatimore, doganore ose ndonjë administratë tjetër kompetente do të bart detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit”*.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43 paragrafi 1 te LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon aktvendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së e detyron të paditurën, që në riprocedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi. Gjykata e obligonë te paditurën se ne rishqyrtim dhe rivendosje, te deklarohet lidhur provat te cilat i'a ka bashkangjitur paditësi kësaj lende lidhur faturën dhe transaksionin bankar për pagesën e mallit lëndor si dhe të konstatojë këto pretendime dhe argumente te paditësit, dhe si rrjedhojë pas konstatimi te kësaj gjendje faktike te marr vendim te drejte dhe te bazuar ne dispozitat ligjore te KDA-së, dhe nëse konstatohen pretendimet e tilla e paditura ne rivendosje duhet t’ia pranojë paditësit deklarimin e mallit ne bazë të faturës përkatësisht vlerës se transaksionit, si dhe të kthejë detyrimin e paguar më tepër. Vërejtjet e cekura janë te obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81.C, 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal**  
**A.nr.1011/19, datë 08.12.2020**

Sekretare Juridike  
Fexhrie Tashevci

Gj y q t a r i  
Ramush Bardiqi

**KESHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.